



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 tetor 2012
Nr. ref.:RK319/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI03/12

Parashtrues

Kastriot Gerbeshi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
PKL. Nr. 88/2011, të 21 shtatorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Kastriot Gerbeshi nga Prishtina, Kosovë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës pohon se, gjykimi dhe dënimi i tij në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për vjedhje të rëndë, shkel të drejtat e tij mbi bazën se trupi gjykues, për rastin e tij, ishte formuar gabimisht, se për ankesën e tij ishte marrë vendim i gabuar dhe se kërkesa e fundit për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme, përbën shkelje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (neni 452, paragrafi 3).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 20 janar 2012, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
5. Më 7 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditën, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
6. Më 17 prill 2012, Gjykata i shkroi parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi sqarim përkitazi me datën e parashtrimin të ankesës për dënimin e tij dhe nëse ai, apo përfaqësuesi i tij ligjor, kontestonin përbërjen e trupit gjykues para dënimit të tij në Gjykatën Komunale.
7. Më 22 maj 2012, Gjykata përsëri i shkroi parashtruesit të kërkesës, duke e këshilluar atë për numrin e referencës së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 19 shtator 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH.03/12, caktoi Kolegjin e ri shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani, pas përfundimit të mandatit të gjyqtarëve Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami si gjyqtare të Gjykatës.
9. Më 17 tetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit, siç pretendohet në dokumentet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës

10. Parashtruesi i kërkesës ishte dënuar nga një koleg për të mitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për veprën vjedhje të rëndë, P. nr. 660/2008, të 30 majit 2008. Në kohën e kryerjes së veprës, për të cilën ai u dënua në fund, parashtruesi i kërkesës ishte i mitur, meqenëse kishte lindur më 12 shkurt 1990. Megjithatë, në kohën e gjykimit ai ishte i moshës madhore. Ai ishte gjykuar me të bashkëpandehurit e tjerë, që të gjithë të mitur sipas Kodit të drejtësisë për të mitur. Ai u dënua me një vit e gjashtë muaj burgim. Koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritej.
11. Ankesa kryesore e parashtruesit të kërkesës ishte se trupi gjykues në Gjykatën Komunale nuk përbëhej nga gjyqtarë të gjinive të ndryshme, siç e kërkohet me ligj, dhe se aktgjykimi nuk ishte i mbështetur me dëshmi, apo i arsyetuar mirë.

12. Ai u ankua kundër dënimit të Gjykatën së Qarkut në Prishtinë, Ap. Nr. 416/2008, të 9 prillit 2011, i cili gjeti se koha për ankesë kishte kaluar. Nga dosja e lëndës, Gjykata e Qarkut konstatoi se ankesa është dashur të paraqitej më 26 qershor 2008, ndërsa është parashtruar më 27 qershor 2008. Gjykata e Qarkut gjithashtu deklaroi se, edhe në qoftë se do të parashtrohej me kohë, ankesa nuk do të ishte e lejueshme për shkak se nuk arsyetonte bazën mbi të cilën mund të kontestohet aktgjykimi.
13. Kundër kësaj, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Pkl. nr. 88/2011, e 21 shtatorit 2011, e cila i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 tetor 2011. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Shkeljet e pretenduara të Kushtetutës

14. Parashtruesi i kërkesës, përveç shkeljeve të pretenduara të Kodit të Procedurës Penale, pretendon se janë shkelur edhe neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore – E drejta për gjykim të drejtë – dhe Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (pa saktësuar ndonjë nen të veçantë).

Ligji

15. Neni 49 i Kodit për të mitur të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2004, përkitazi me përbërjen e trupave gjykues për rastet ku të pandehurit janë të mitur, parasheh si vijon:

Kapitulli XI

Përbërja e trupave gjykues për të mitur

Neni 49

(1) Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë, me përjashtim të kolegjeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një gjyqtar për të mitur dhe dy gjyqtarë laikë. Gjyqtari për të mitur është kryetari i trupit gjykues.

(2) Kolegji për të mitur në Gjykatën Supreme të Kosovës përbëhet nga tre gjyqtarë duke përfshirë së paku një gjyqtar për të mitur. Kur trupi gjykues për të mitur gjykon në shqyrtimin gjyqësor, do të përbëhet nga dy gjyqtarë për të mitur dhe tre gjyqtarë laikë.

(3) Gjyqtarët laikë në trupin gjykues për të mitur zgjedhen nga mesi i profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve.

(4) Gjyqtarët laikë që marrin pjesë në trupin gjykues për të mitur janë të gjinive të ndryshme.

16. Për më tepër, edhe pse parashtruesi i kërkesës ishte në moshën madhore në kohën e gjyqimit dhe të dënimit, më 22 maj 2008, neni 3 i Kodit për të mitur parasheh:

Neni 3

(1) Dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj cilitdo personi të akuzuar për veprë penale të kryer si i mitur, pavarësisht nga moshja e tij në kohën e fillimit të procedurës.

(2) Kur ky Ligj e parasheh, dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj cilitdo personi të akuzuar për veprë penale të kryer si madhor i ri.

(3) Kur madhori akuzohet për veprë penale të kryer si i mitur, nenet 41 dhe 45 të këtij

Ligji nuk zbatohen.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren punës.

18. Neni 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, i Kushtetutës krijon kornizën e përgjithshme ligjore për pranueshmëri. Ai parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Për më tepër, neni 48 i Ligjit, thotë:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

20. Përfundimisht, rregulli 36 i Rregullores së punës, parasheh:

*“1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa është qartazi e bazuar.*

2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

21. Ankesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Komunale u gjykua nga Gjykata e Qarkut si e paafatshme. Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të ofrojë dëshmi se kërkesa ishte parashtruar me kohë dhe i mundësoi parashtruesit të kërkesës të cekë se si kishte gabuar Gjykata Komunale në konstatimet e veta. Parashtruesi i kërkesës nuk dha kurrfarë përgjigje.

22. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka dështuar t'i përgjigjet konkludimit të gjykatës vendëse, ngase ai nuk arriti të parashtronte ankesë në kohën e duhur. Prandaj, kjo nënkupton se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për ankesë. Kështu, ai ka dështuar të sherojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë.

23. Veç kësaj, nga parashtruesi i kërkesës ishin kërkuar informata se kur ai, apo përfaqësuesi i tij ligjor, së pari kishin kundërshtuar përbërjen e kolegjit të Gjykatës Komunale, që e shqyrtoi rastin e tij. As për këtë çështje nuk pati përgjigje.

24. Andaj, duket se ka mungesë të dëshmive mbi të cilat Gjykata Kushtetuese mund të konstatoj ndonjë shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Në bazë të kësaj, duket se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të mbështesë kërkesën e tij në këtë Gjykatë.
25. Prandaj, Gjykata konkludon se, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, në bazë të nenit 48 dhe të nenit 56 të Ligjit, dhe në bazë të rregullit 36.2 (a dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse nuk është arsyetuar *prima facie*, apo mbështetur sa duhet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas këshillimit më 17 tetor 2012, në përputhshmëri me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe Rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani

